



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Seanca plenare e Kuvendit
P- 100
Prishtinë, më 25 shkurt 2010

PROCESVERBAL

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 25 SHKURT 2010**

Seancën e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetari i Kuvendit, ndërsa i ndihmoi **Sabri Hamiti**, anëtar i Kryesisë së Kuvendit.

Kryetari konstatoi se në sallë janë të pranishëm 85 deputetë.

Në fillim të seancës, për fjalë u paraqitën këta deputetë:

Deputetja **Drita Kadriu** njoftoi Kuvendin se në Mitrovicë është duke u mbajtur “Java e minatorëve”. Ajo përkujtoi grevën e minatorëve të Trepçës gjatë grevës së viti 1989, si dhe jehonën e saj në zhvillimin e proceseve politike në Kosovë.

Deputeti **Bujar Dugolli** propozoi që Kuvendi në seancën e sotme ose në seancën e radhës të diskutojë lidhur me rastin e liderit të “Vetëvendosjes”, Albin Kurti, dhe në fund të nxjerrë një rezolutë.

Ministri **Idriz Vehapi** propozoi që pika e katërt të hiqet nga rendi i ditës.

Kryetari i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Ndërkohë, grupet parlamentare: Për Integrim dhe ai i SLS-së kanë bërë propozim me shkrim për emërimin e deputetëve të këtyre grupeve për anëtarë në komisione parlamentare.

Me propozimin e kryetarit, Kuvendi vendosi që kjo çështje të radhitet si pikë e fundit e kësaj seance.

Kuvendi, në vazhdim i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite:

1. Miratimi i Procesverbalit të seancës plenare, të mbajtur më 11 shkurt 2010,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Shqyrtimi i parë i Projekt-kodit të drejtësisë për të mitur,
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për organizmat e modifikuar gjenetikisht,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për pyjet e Kosovës,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për mbrojtjen e ajrit nga ndotja,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për financimin e programeve të veçanta të banimit,
8. Propozim-Programi i Punës së Kuvendit për vitin 2010,
9. Propozim-Plani i Veprimit i Kuvendit për integrimet evropiane për vitin 2010,
10. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit të Qeverisë së Kosovës për lejimin e pagesës për furnizim me vaksina,
11. Propozimi i Grupit Parlamentar për Integrim për emërimin e deputetëve për anëtar në komisione parlamentare

1. Miratimi i Procesverbalit të seancës plenare, të mbajtur më 11 shkurt 2010

Procesverbali i seancës plenare të mbajtur më 11 shkurt 2010, u miratua pa vërejtje.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputetja Gjylnaze Syla parashtroi pyetje për kryeministrin, Hashim Thaçi, lidhur me atë se kur do të hapet Universiteti publik në Gjakovë?

Kryeministri Thaçi iu përgjigj pyetjes se deputetes Syla.

Deputetja **Drita Maliqi** parashtroi pyetje për ministrin e Arsimit, Enver Hoxhaj, lidhur me hapjen e Universitetit në Gjilan.

Kryeministri Thaçi iu përgjigj pyetjes se deputetes Maliqi.

Deputetja **Myrvete Pantina** parashtroi pyetje për ministrin e Tregtisë dhe të Industrisë, Lutfi Zharku, lidhur me shkaqet e shuarjes së mija ndërmarrjeve në Kosovë.

Ministri Lutfi Zharku nuk ishte prezent në seancë.

Deputeti Shkumbin Demaliaj parashtroi pyetje për kryeministrin, Hashim Thaçi, lidhur me atë se sa sekretarë permanentë punojnë në ministrinë e Qeverisë së Kosovës.

Kryeministri Thaçi iu përgjigj pyetjes se deputetit Demaliaj.

Deputetja **Sanije Aliaj** parashtroi pyetje për ministrin e Arsimit, Enver Hoxhaj, pse edhe pas dy viteve të funksionimit të shtetit të pavarur të Republikës së Kosovës lejohet komuniteti goran të punojë me plan-programet e Qeverisë së Sërbisë.

Ministri Enver Hoxhaj nuk ishte prezent në seancë.

Deputetja **Nerxhivane Dauti** parashtroi pyetje për ministrin e Administratës Publike, Arsim Bajrami, lidhur me atë se kur do të procedohet për miratim në Kuvendin e Kosovës Ligji për konfliktin administrativ.

Ministri Arsim Bajrami iu përgjigj pyetjes së deputetes Dauti.

Deputeti **Esat Brajshori** parashtroi pyetje për kryeministrin, Hashim Thaçi, lidhur me atë se a do të ndërtohet autostrada sipas deklaratës tuaj Vërmicë-Prishtinë-Merdare apo sipas deklaratës së ministrit të transportit Besi-Sllatinë-Orllat-Vërmicë.

Kryeministri Thaçi iu përgjigj pyetjes se deputetit Brajshori.

Deputeti **Naim Rustemi** parashtroi pyetje për ministrin e Ekonomisë dhe të Financave, Ahmet Shala, lidhur me atë se ku është garancia bankare për 16 milionë euro për Operatorin e dytë të Telefonisë mobile

Ministri Ahmet Shala iu përgjigj pyetjes se deputetit Rustemi.

Deputeti **Bujar Dugolli** parashtroi pyetje për ministrin e Ekonomisë dhe të Financave, Ahmet Shala, lidhur me menaxhimin e ndërmarrjes publike “Termokos” në Prishtinë.

Ministri Ahmet Shala iu përgjigj pyetjes se deputetit Dugolli.

Deputetja **Teuta Hadri** parashtroi pyetje për ministrin e Shëndetësisë, Alush Gashi, lidhur me pengesat në prodhimin vendor të barnave, siç është rasti “Kondirolli”.

Ministri Gashi iu përgjigj pyetjes së deputetes Hadri.

Deputeti **Xhevdet Neziraj** parashtroi pyetje për ministrin për Komunitete dhe Kthim, Sasha Rashiq, lidhur me ndërtimin e banesave për komunitetet tjera.

Ministri Sasha Rashiq nuk ishte prezent në seancë.

Deputetja **Luljeta Shehu** parashtroi pyetje për ministren e Drejtësisë, Nekibe Kelmendi, lidhur me trajtimin e personave të mitur në burgjet e Kosovës që kanë kryer vepra penale.

Ministrja Kelmendi iu përgjigj pyetjes së deputetes Shehu.

3. Shqyrtimi i parë i Projekt-kodit të drejtësisë për të mitur

Kryesuesi ftoi ministren e Drejtësisë që në emër të Qeverisë ta prezantojë Projekt-kodin e drejtësisë për të mitur.

Nekibe Kelmendi tha se në vazhden e kompletimit të fushës legislative, ministria që ajo drejton, krahas draftimit të katër projektligjeve bazë për reformën gjyqësore, ka përgatitur draftin e Projekt-kodit të drejtësisë për të mitur.

Projekt-kodi është hartuar në pajtueshmëri me standardet më të larta të rregullimit të çështjeve nga kjo fushë dhe draftimi i këtij Projekt-kodi është bërë edhe me prezencën e ekspertëve të UNICEF-it, tha ajo.

Ky Projekt-kod rregullon çështjet që kanë të bëjnë me shqiptimin dhe ekzekutimin e masave dhe të dënimeve ndaj të miturve, procedurat gjyqësore lidhur me këtë çështje etj. Projekt-kodi ka 163 nene dhe po ashtu ka një kosto financiare që lidhet me investimet kapitale. Në fund, ajo i ftoi deputetët për miratim, në parim, të Projekt-kodit të drejtësisë për të mitur.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin, në parim, të Projekt-kodit të drejtësisë për të mitur.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projekt-kod dhanë këta deputetë: në emër të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, Bahri Hyseni, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Selvije Halimi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Adem Hajdaraj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Shkumbin Demaliaj, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Ibrahim Makolli, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Adem Salihaj, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, Myfera Shinik, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar për Integritet, Numan Baliq, si dhe deputetët: Riza Smaka, Gjylnaze Sylaj, Zylfije Hundozi dhe Nekibe Kelmendi, që janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim miratimin e këtij projekt-kodi. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----65,

Kundër-----1,
Abstenime-----2.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash miratoi Projekt-kodin e drejtësisë për të mitur.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Buxhet dhe Financa, Komisionin për Komunitete dhe Komisionin për Integritet Evropian që ta shqyrtojnë këtë projekt-kod brenda dy muajve dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për organizmat e modifikuar gjenetikisht

Kryesuesi hodhi në votim propozimin e sponsorit të Projektligjit dhe të komisionit funksional. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----59,
Kundër----- 1,
Abstenime----- 2.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi ia kthen Qeverisë së Kosovës Projektligjin për organizmat e modifikuar gjenetikisht, për ripunim.

5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për pyjet e Kosovës

Kryesuesi i njoftoi deputetët e Kuvendit për procedurën e shqyrtimi të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për pyjet e Kosovës, si dhe për raportet dhe rekomandimet e komisioneve kryesore dhe të komisionit funksional për këtë projektligj.

Kryesuesi i hodhi në votim, një nga një, amendamentet e propozuara nga Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural , Mjedis dhe Planifikim Hapësinor.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 1, 2, 3 dhe 4.

Pastaj, kryesuesi hodhi në votim Projektligjin dhe amendamentet e miratuara. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----64,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi miratoi Ligjin nr. 03/L-153 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për pyjet e Kosovës.

6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për mbrojtjen e ajrit nga ndotja

Kryesuesi i njoftoi deputetët e Kuvendit për procedurën e shqyrtimi të Projektligjit për mbrojtjen e ajrit nga ndotja, si dhe për raportet dhe rekomandimet e komisioneve kryesore dhe të komisionit funksional për këtë projektligj.

Kryesuesi i hodhi në votim, një nga një amendamentet e propozuara nga Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural , Mjedis dhe Planifikim Hapësinor.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26 dhe 27.

Pastaj, kryesuesi hodhi në votim projektligjin dhe amendamentet e miratuara. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----67,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 3.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi miratoi Ligjin nr. 03/L-160 për mbrojtjen e ajrit nga ndotja.

7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për financimin e programeve të veçanta të banimit

Kryesuesi i njoftoi deputetët e Kuvendit për procedurën e shqyrtimi të Projektligjit për financimin e programeve të veçanta të banimit, si dhe për raportet dhe rekomandimet e komisioneve kryesore dhe të Komisionit funksional për këtë projektligj.

Kryesuesi i hodhi në votim, një nga një amendamentet e propozuara nga Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural , Mjedis dhe Planifikim Hapësinor.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18 dhe 19.

Pastaj, kryesuesi hodhi në votim projektligjin dhe amendamentet e miratuara. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----57,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 5.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi miratoi Ligjin nr. 03/L-164 për financimin e programeve të veçanta të banimit.

8. Propozim-Programi i Punës së Kuvendit për vitin 2010

Kryesuesi tha se Programi i Punës së Kuvendit për vitin 2010, paraqet dokument bazë të Kuvendit për aktivitetin e organit ligjvënës të Republikës së Kosovës.

Ky program, tha ai, është hartuar duke u bazuar në këto dokumente: dokumentin e Qeverisë për Strategjinë legjislative për vitin 2010, planet e punës së komisioneve parlamentare për vitin 2010, Planin e veprimit të Kuvendit, të 10 dhjetorit 2008, dhe Planin e veprimit të Kuvendit për integritet evropian për vitin 2010.

Diskutime dhe opinione për këtë pikë të rendit të ditës dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Ramë Buja, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Eqrem Kryeziu, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Gjylnaze Sylja, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Ibrahim Gashi, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Lulzim Zeneli, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, Xhezair Murati, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar për Integritet, Vezira Emrush, si dhe deputetët: Suzan Novobrdaliu, Edita Tahiri, Emrush Xhemajli, Sanije Alija, Bujar Dugolli, Naser Rugova, Myrvete Pantina, Flora Brovina, Gani Koci, Riza Smaka, Nurishahe Hulaj, Armend Zemaj, Shkumbin Demaliaj, Driton Tali, Berim Ramosaj, Bahri Hyseni, Kaqusha Jashari, Berat Luzha, Hydajet Hyseni, Naim Rustemi, Sabri Hamiti dhe Ardian Gjini, që janë paraqitur në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Kryesuesi e hodhi në votim Programin e Punës së Kuvendit për vitin 2010, mbi bazën e ndryshimeve të mundshme, të diskutuara në Kuvend.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----56,

Kundër-----7,

Abstenime-----4.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, mori këtë

V E N D I M

1. Miratohet Programi i Punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin 2010.
2. Kërkohet nga Qeveria e Kosovës që t'i përshpejtojë afatet e parashtrimit në Kuvend të këtyre projektligjeve me prioritet të lartë, deri më 30 qershor 2010:
 1. Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/12 për qasje në dokumente zyrtare,
 2. Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-134 për lirinë e asocimit në organizatat joqeveritare,
 3. Ligjit për zgjedhjet qendrore,
 4. Projektligjit për energjinë elektrike,
 5. Projektligjit për Bankën Qendrore,

6. Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për vetëqeverisjen lokale,
7. Projektligjit për gjykatat,
8. Projektligjit për Këshillin Gjyqësor,
9. Projektligjit për Këshillin Prokurorial,
10. Projektligjit për prokuroritë publike,
11. Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Penal,
12. Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të Procedurës Penale,
13. Projektligjit për mbrojtjen e dëshmitarëve,
14. Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Inspektoratin Policor të Kosovës,
15. Projektligjit për kontrollimin e eksportit.

9. Propozim-Plani i Veprimit të Kuvendit për integrimet evropiane për vitin 2010

Deputetja Zylfije Hundozi, në emër të Komisionit për Integritet Evropiane, e paraqiti rekomandimin dhe arsyetimin e tij.

Për këtë pikë të rendit të ditës nuk pati të paraqitur për diskutim, as nga komisionet funksionale e as nga grupet parlamentare.

Kryesuesi hodhi në votim miratimin e rekomandimit të Komisionit për Integritet Evropiane lidhur me Propozim-Planin e Veprimit të Kuvendit për integrimet evropiane për vitin 2010.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----56,
Kundër-----0,
Abstenime-----1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi mori këtë

V E N D I M

Miratohet Propozim- Plani i Veprimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës për integrimet evropiane për vitin 2010, me rekomandimet e Komisionit Parlamentar për Integritet Evropiane.

10. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit të Qeverisë së Kosovës për lejimin e pagesës për furnizim me vaksina

Kryesuesi tha se Komisioni për Buxhet dhe Financa, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Punës, ka shqyrtuar Propozim-Vendimin e Qeverisë së Kosovës për lejimin e pagesës për furnizim me vaksina, sipas marrëveshjes të nënshkruar ndërmjet UNICEF-it dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Kuvendit ia ka paraqitur rekomandimin për shqyrtim dhe miratim në seancë plenare.

Për këtë pikë të rendit të ditës nuk kishte të paraqitur për diskutim, as nga komisionet funksionale, as nga grupet parlamentare.

Kryesuesi hodhi në votim miratimin e rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa për lejimin e pagesës për furnizim me vaksina.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----46,
Kundër-----0,
Abstenime-----3.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi mori këtë

V E N D I M

Miratohet propozimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për lejimin e pagesës për furnizim me vaksina, sipas marrëveshjes së nënshkruar ndërmjet UNICEF-it dhe Ministrisë së Shëndetësisë.

11. Propozimi i Grupit Parlamentar Për Integritet për emërimin e deputetëve për anëtarë në komisione parlamentare

Kryesuesi tha se në pajtim me rekomandimin e Kryesisë së Kuvendit, Grupi Parlamentar për Integritet dhe Grupi Parlamentar SLS, kanë bërë propozimin për emërimin e deputetëve për anëtarë të komisioneve parlamentare.

Kryesuesi hodhi në votim formal rekomandimin e Kryesisë së Kuvendit lidhur me propozimin e Grupit Parlamentar për Integritet dhe të Grupit Parlamentar SLS për emërimin e deputetëve për anëtarë të komisioneve parlamentare.

Kryesuesi konstatoi se me shumicë votash, Kuvendi miratoi propozimin e Grupit Parlamentar për Integritet dhe të Grupit Parlamentar të SLS-së për emërimin e anëtarëve të komisioneve parlamentare.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi mori këtë

V E N D I M

Për emërimin e anëtarëve të Grupit Parlamentar për Integritet dhe të Grupit Parlamentar të SLS-së në komisionet parlamentare

I. Nga Grupi Parlamentar për Integritet, anëtarë të komisioneve parlamentare emërohen:

1. Në Komisionin për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, emërohet deputeti Dragisha Miriq, në vend të deputetes Kosara Nikoliq,
2. Në Komisionin për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të

- Pagjetur dhe Peticione, emërohet deputeti Danush Ademi zëvendëskryetar i dytë, në vend të deputetes Radmila Vojoviq,
3. Në Komisionin për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural dhe Mjedis e Planifikim Hapësinor, emërohet deputetit Branislav Grbiq, në vend të deputetit Dragisha Miriq,
 4. Në Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, emërohet deputetja Vezira Emrush zëvendëskryetare e dytë, në vend të deputetit Mursel Halili,
 5. Në Komisionin për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media, emërohet deputeti Numan Baliq, në vend të deputetit Dragan Dimiq,
 6. Në Komisionin për Mandate, Imunitete dhe Rregullore të Punës së Kuvendit, emërohet deputeti Vlladimir Todoroviq, në vend të deputetes Radmilla Vojoviq,
 7. Në Komisionin për Mbikëqyrjen e Agjensionit Kosovar për Inteligjencë, emërohet deputeti Mihailo Shqepanoviq, në vend të deputetit Dragan Dimiq.

II. Nga Grupi Parlamentar SLS, anëtarë në komisione parlamentare emërohen:

1. Në Komisionin për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, deputeti Petar Miletiq emërohet kryetar i Komisionit, në vend të ish -deputetit Bojan Stojanoviq.
2. Në Komisionin për Integritet Evropian, emërohet deputeti Petar Miletiq, anëtar, në vend të ish-deputetit Bojan Stojanoviq.

Kryetari e deklaroi të mbyllur seancën plenare në orën 17:00.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

Përgatiti: Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale